VENDIM
Nr.522, datë 8.7.2005

PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE FINANCIARE TË KREDITORËVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM NGA LLOGARITË BANKARE TË RAIFFEISEN BANK SHA, TE BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet financiare të shoqërive huamarrëse në administrim, gjendje pranë Raiffeisen Bank sh.a., të caktuara me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave për shpërndarje kreditorëve, sipas koeficientit të kthimit të shumave pas rakordimeve dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga administratorët e pavarur, të transferohen pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në llogari të veçanta bankare, në dobi të kreditorëve të secilës shoqëri huamarrëse.

2. Raiffeisen Bank sh.a., në madhësinë e vlerës financiare për transferim, krahas të ardhurave të caktuara për çdo kreditor, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, sipas koeficientëve të kthimit të shumave, të llogarisë për çdo shoqëri huamarrëse në administrim, interesat bankarë në përfitim nga koha e depozitimit të vlerave financiare për shpërndarje deri në transferimin e tyre, në përputhje me kushtet e punës, të pranuara nga banka për të gjithë klientët sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

3. Ngarkohen administratorët e pavarur të shoqërive huamarrëse që, në përfundim të rakordimit të numrit të kreditorëve, për vlerat financiare të shpërndara dhe ato të mbetura gjendje për transferim te Banka Kombëtare Tregtare të tërheqin dhe të administrojnë të gjithë dokumentacionin e pagesave të kryera kreditorëve nga ish-Banka e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank sh.a., përfshi kontratat e huamarrjes, mandatpagesat dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, të përdorur për shlyerjen e tyre.

4. Kudo në vendimet nr.47, datë 3.2.1997, nr.610, datë 21.12.1999, nr.162, datë 13.4.2000, nr.163, datë 13.4.2000, nr.361, datë 14.7.2000, nr.116, datë 31.2.2002 dhe nr.491, datë 23.7.2004 të Këshillit të Ministrave, emërtimet "...Banka e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank sh.a...." zëvendësohen me "...Banka Kombëtare Tregtare...".

5. Ngarkohet Banka Kombëtare Tregtare, me degët e saj në rrethe që, në përputhje me marrëveshjen, që do të lidhet në zbatim të këtij vendimi ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe kësaj banke, të bëjë shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të mbetur të fondacionit "Populli" dhe "Xhaferri", të shoqërive huamarrëse "M. Leka" sh.p.k., "Universi" sh.p.k, "Global Foods" sh.p.k., "Silva" sh.p.k., "Cenaj & Co" sh.p.k. dhe "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano